




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇANI



Në bazë të kërkesës së OVL-dega në Deçan, të dt.21.02.2018, nr.02-5262, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shtatores së Dëshmorit të Kombit Beg Rizaj, duke u bazuar në nenin 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 21 dhe 25 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.28.02.2018, bie këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E SHTATORES SË DËSHMORIT TË KOMBIT BEG RIZAJ

I.

Caktohet lokacioni për ndërtimin e shtatores së Dëshmorit të Kombit Beg Rizaj, në parcelën nr.1110-0, Çertifikata P-70505021-01110-0, me kulturë Park, Zona Kadastrale Deçan, e evidentuar si P.SH.Komuna e Deçanit.

II.

Implementimin e këtij Vendimi do ta bënë Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Deçanit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Me Vendim njoftohen: Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.II-9

Deçan,dt.28.02.2018

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Haki Shehaj

Forma e regjistrimit të vendimit:

Numri i regjistrimit: 01

Data: 28.03.18

Deçan, Deçane